

**VENDIM**  
**Nr. 650, datë 3.11.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË  
MINISTRIT TË SHETËTIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E  
REFORMAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për hartimin e ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Ndjek e bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:

i. hartimin e miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara;

ii. planifikimin e shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. drejtimin e koordinimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;

iv. ndjekjen, koordinimin, monitorimin e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara autoriteteve përgjegjëse, në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019;

b) Kontakton e bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për:

i. prezantimin e gjendjes dhe të dëmeve të shkaktuara;

ii. përgatitjen e propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. detajimin e nevojave dhe paraqitjen e kërkesave për donacione financiare dhe mbështetje të specializuar njerëzore;

iv. informimin e secilit prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre.

3. Nxit, bashkërendon e jep mendim për projektaktet që propozohen nga ministrat, të cilat trajtojnë, ndër të tjera, edhe çështje me interes ose brenda fushës së përgjegjësive së tij.

4. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në marrëdhëniet e informimit të publikut për çështjet brenda fushës së tij të përgjegjësive.

5. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për koordinimin dhe drejtimin e punës, ndërmjet ministrive dhe institucioneve, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19.

Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për:

a) koordinimin, drejtimin e ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

b) evidentimin e burimeve financiare të jashtme dhe përcaktimin e mënyrës së përthithjes së tyre, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve përkatëse, për përdorimin e këtyre burimeve;

c) koordinimin e drejtimin e strukturave e të njëjseve, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

ç) prezantimin e gjendjes dhe të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

d) përgatitjen e propozimin e projekteve, të përgjithshme dhe të veçanta, si pjesë të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

dh) detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

e) koordinimin e drejtimin e punës, si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen e paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;

ë) nxitjen, bashkërendimin e dhënien e mendimit për projektaktet që propozohen nga ministrinë, të cilat trajtojnë, ndër të tjera, edhe çështje me interes ose brenda fushës së përgjegjësisë së tij;

f) thirrjen për raportim të strukturave, të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;

g) krijimin e drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;

gj) bashkërendimin me ministrinë dhe institucionet shtetërore, për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive, në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;

h) informimin, vazhdimisht dhe në kohë, të Kryeministrit, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19.

6. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave është përgjegjës për:

a) hartimin e programit të reformave në çdo sektor, sipas fushave përkatëse të institucioneve përgjegjëse, në bashkëpunim me këto të fundit;

b) koordinimin e institucioneve përgjegjëse për hapat që duhet të ndërmerren, me qëllim realizimin e programit të reformave;

c) monitorimin, në mënyrë periodike, të ecurisë së programit të reformave nga institucionet përgjegjëse;

ç) mbikëqyrjen e dhënien e rekomandimeve përkatëse për institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e zbatimit të reformave të ndërmarra apo të atyre në vijim;

d) prezantimin e ecurisë së zbatimit të programit të reformave te Kryeministri, në bashkëpunim me institucionin përgjegjës.

7. Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, ka këto kompetenca:

a) merr pjesë në mbledhjet e Komitetit të Emergjencave Civile;

b) thërret për raportim e ngarkon me detyra strukturat e mbrojtjes civile;

c) krijon grupet e punës dhe organizon veprimtarinë për hartimin e miratimin e programeve të procesit të rindërtimit;

ç) bashkërendon me ministrinë e institucionet shtetërore, për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive, në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit;

d) drejton e koordinon, në nivel qendror, strukturat operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit;

dh) informon vazhdimisht dhe në kohë Kryeministrin, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit e të përdorimit të burimeve materiale e njerëzore;

e) kontakton në vijimësi dhe për çështje të veçanta me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për garantimin e ekspertizës së hartimit e për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;

ë) monitoron në mënyrë periodike ecurinë e programit të reformave të institucioneve përgjegjëse;

f) mbikëqyr dhe jep rekomandime për institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e zbatimit të reformave.

8. Vendimi nr. 11, datë 10.1.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**